

Lista e dokumentacionit të nevojshëm për njoftim rreth infrastrukturës teknike të Telekomit

Çdo entitet (person juridik apo fizik), nëse planifikon ta zbatojë një plan ndërtimi në një lokacion të caktuar, duhet të aplikojë paraprakisht në ndërmarrjet publike për të parë nëse ato kanë infrastrukturë në atë lokacion, në mënyrë që të mos ketë dëmtim, zhvendosje apo zgjerim gjatë punimeve të tyre.

Për ta lehtësuar procesin e aplikimit për leje pune dhe për t'u siguruar që të gjitha kërkesat e operatorëve / personave fizikë të plotësohen sipas standardeve të kërkuara, kompania jonë ofron mundësinë e dorëzimit të aplikimit në sportelet e pikave tona të shitjes dhe të kujdesit për klientë.

Është në interes si të kompanive, si të personave fizikë që kohëzgjatja e këtij procesi të jetë sa më e shkurtër. Për këtë arsye, dokumentacioni i kërkuar duhet patjetër të jetë i plotë dhe i saktë, në mënyrë që të vazhdohet me tej me procesin e aprovimit.

Më poshtë i gjeni detajet dhe kushtet specifike që duhet të plotësohen nga aplikuesit për t'u siguruar që kërkesa të shqyrtohet në mënyrë efektive.

Dokumentacioni i nevojshëm:

| Lista e dokumenteve |
|---|
| Plotësimi i kërkesës (Formularit) me shkrim në pikën e shitjes dhe të kujdesit për klientë në regjionin përkatës |
| Vendimi i kushteve ndërtimore nga Kuvendet Komunale |
| Kopja e Planit nga Zyra Kadastrale Komunale |
| Certifikata nga Njësia Kadastrale ose Aktvendimi për bashkimin / ndarjen e parcelave |
| Certifikata e Regjistrimit të kompanisë (nuk vlen për persona fizikë) |
| Autorizimi për personin e caktuar nga kompania e cila aplikon për Leje Ndërtimi – Pune, me të dhënat për kontaktimin e personit |
| Projekt punimi në OrtoFoto me të cilën kompania dëshmon se do t'i kryejë punimet e cekura në projekt (aplikohet te kompanitë ndërtuese) |

*Shënim: *Telekomi i Kosovës Sh.A. rezervon të drejtën e ndryshimit të listës, varësisht nga ndryshimet që aplikohen nga njësitë komunale.*